



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 225/1 Prot

Tiranë, më 13.01. 2022

NJOFTIM

Drejtuar: Autoriteteve dhe Enteve Kontraktore

Operatorëve Ekonomikë

Agjencia e Prokurimit Publik njofton të gjitha palët e interesuara se, në mbështetje të neneve 100/2 dhe 103/1 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”), Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”.

Qëllimi i këtij vendimi është rregullimi i kuadrit legjislativ për prokurimin publik sipas ndryshimeve ligjore të miratuara së fundmi. Për herë të parë, prokurimi i shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, sipas parashikimeve të LPP, i nënshtrohen një regjimi të posaçëm, të thjeshtuar prokurimi.

Vendimi përcakton llojet e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojet e shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave, si dhe rregullat që do të zbatohen në prokurimin e tyre.

Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 04, datë 12.01.2022 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Duke ju falenderuar,

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

